



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

Nr 519 Prot

Tiranë, më 22.05 2020

VENDIM

Nr. 8, datë 22.05.2020

“PËR

**NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN E STUDIMEVE TË DOKTORATËS SË UNIVERSITETIT
POLITEKNIK TË TIRANËS”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, shkronja d, VKM nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës dhe Tiranë”, VKM nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Urdhri Nr. 91, datë 09.03.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike”, Urdhri nr. 31, datë 23.03.2020 të Rektorit, “Mbi zhvillimin e procesit mësimor online në Universitetin Politeknik të Tiranës”; në relacionin e datës 13.05.2020 të Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Sektorit Juridik si pasojë e gjendjeve të fatkeqësive natyrore të shkaktuara nga lëkundjet sizmike të datës 26 nëntor 2019 dhe pandemisë globale të shkaktuar nga virusi COVID – 19, si dhe ndërprerjes së procesit mësimor për një periudhë të gjatë kohore në Universitetin Politeknik të Tiranës, në vendimin nr. 02, datë 10.04.2020 të KP të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe në kërkesën për shtyrje të afatit të një numri të konsiderueshëm doktorantësh, Senati Akademik në mbledhjen e datës 22.05.2020,

VENDOSI:

1. Në Rregulloren e Studimeve të Doktoratës së Universitetit Politeknik të Tiranës, të miratuar me Vendimin nr. 12, datë 25.06.2019 të Senatit Akademik, pika 5 e nenit 14, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Afati maksimal për dorëzimin e dosjes te drejtuesi i njësisë kryesore, për fillimin e procedurës së marrjes së gradës shkencore “doktor” për kandidatët e pikës 4 të nenit 14, do të jetë data 30 qershor 2021”.

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi “Nene Tereza”, Nr.4, Tirane,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

2. Ngarkohen Komisionet e përhershme për dhënien e gradës shkencore "Doktor" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea MALIQARI

